



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezimi / Primi / Prezentimi / Received / Delivered	25-06	2021	1	viti / god year
Organ / Njësia / Organ / Jediniца / Organ / Unit	Si Prot / Prot No	Shtesa / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity	
SKINUSHAH	3313/2021		114	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.314/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.314/2021 të datës 29.04.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga “Rexhë Destani”, pa numër në Istog, kundër Vendimit KA.NR.001/21 të datës 31.03.2021 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike ‘‘masë disiplinore-largim nga shërbimi civil’’, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 25.06.2021, mori këtë’’

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.314/2021 e datës 29.04.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi KD.NR.001/21 i datës 31.03.2021 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi, më datë 04.02.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Nr. Prot:465/2021, kundër Vendimit me Nr. 17/21 të datës 20.01/2021 të Komisionit Disiplinor i Qendrës Korrektues në Dubravë/Shërbimit Korrektues të Kosovës me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore largim nga shërbimi civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës më datë 08.02.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Shërbimi Korrektues i Kosovës. Këshilli më datë 10.02.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, më datë 15.03.2021 ka nxjerr Vendim A.nr.59/2021 me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit duke e obliguar Komisionin Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës që të bëjë shqyrtimin e rastit të ankuesit.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 31.03.2021 ka nxjerr Vendim KA.NR.001/21 me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore ‘‘largim nga shërbimi’’.



Ankuesi kundër këtij vendimi përmes e-amili ankesa.kpmshck@rks-gov.net, më datë 28.04.2021 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar më datë 29.04.2021 me Nr. Prot:2064/2021.

Meqenëse lënda është specifike, atehërë Kryetari i Kolejgit për Shqyrtimin dhe Vendosejn e Ankesave, më datë 09.06.2021 ka parashtruar kërkese për shtyrje të afatit për vendosje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën e ankuesit. Kryesuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin Civil të Kosovës më datë 10.06.2021 ka nxjerr Vendim VK.nr.27/2021 me të cilin ka bërë vazhdimin e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për 10 ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 28.04.2021 e regjistruar më datë 29.04.2021 me Nr. Prot:2064/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 28.04.2021 nga ankuesi për ankesa.kpmshck@rks-gov.net; Procesverbl i datës 29.03.2021 për intervistimin e ankuesit; Vendimin KD.NR.001/21 të datës 31.03.2021 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Ftesë për intervistë; Vendimin A.nr.59/2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 19.03.2021 për themelimin e Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Fletëkthese e datës 06.04.2021; Kërkese për përgjigje ne ankesë e datës 05.05.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 07.05.2021; Kërkesën për shtyrje të afatit për vendosjen e ankesës e datës 09.06.2021; Vendimin VK.nr.27/2021 të datës 10.06.2021 të Kryesuesit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 04.02.2021 me Nr. Prot:465/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 04.02.2021 nga ankuesi për ankesa.kpmshck@rks-gov.net; Vendimin me Nr. 17/21 të datës 20.01/2021 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Thirrje për intervistë e datës 13.01.2021; Vendimin me Nr. 276/20 i datës 19.12.2020 i Komisionit Disiplinor të SHKK-së; Kontratë Pune për Kohë të Caktuar e datës 21.06.2018; Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin i datës 19.12.2020 i Policisë së Kosovës në Istog; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Pejë-Dega Istog e datës 25.01.2021; Pasqyra nga Banka Ekonomike; Vendim me Nr. 10/21 i datës 14.01.2021 për themelimin e Komisionit Disiplinor i Qendrës Korrektuese Dubravë; Kontratën e Punës së Certifikatën e Kolegjit Biznesi për Akt Emërimin e Syla; Certifikatën e Fakultetit Juridik për Vendimin e datës 14.10.2020 për caktimin e Syla si zëvendësues i Zëvendës Drejtorit të Qendrës Korrektuese Dubravë; Akt Emërimin e Diplomën e Kolegjit Juridica për Kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore e datës 13.01.2021 për ankuesin nga Raport Informativ i Sigurisë i datës 18.12.2020; E-mailin e datës 13.01.2021 nga për Shkresë për gjetjet e kontrabandës tek Zyrtari Korrektues e datës 19.12.2020; Raport Informativ i Sigurisë i datës 21.09.2020 dhe 27.09.2019; Shkresë për Drejtorin; Fotot e datës 19.12.2020; Shkresë e datës 19.12.2020 nga Departamenti i Sigurimit; Raport Zyrtar i datës 19.12.2020 dhe Përgjigje në ankesë e datës 10.02.2021 nga SHKK.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit është e **pabazuar, sepse:**

Ankuesi i punësuar sipas Kontratës për Kohë të pacaktuar si personel Korrektues të datës 21.06.2018 në pozitën “Zyrtar Korrektues” në Qendrën Korrektuese në Dubravë në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Në bazë të raportit të incidentit të datës 19.12.2020 të përgatitur nga Of.

në të cilin thuhet se: “*sot më datë 19.12.2020 Departamenti i Sigurimit ka bërë bastisje të organizuar me preke për stafin e ndërrimit të natës. Gjatë bastisjes rreth orën 07:40 në kuletën e zyrtarit korrektues është gjetur një telefon mobil i tipit UNIHERTZ, modeli JELLY PRO me nr.serik:352897092518203 (Made in China) pa sin kartelë dhe jo i mbushur me bateri. Zyrtar korrektues në momentin e bastisjes kuletën e tij nuk e ka futur në skener me qëllim që mos ti detektohet*

telefoni në skaner. Për rastin është njoftuar ZV. Drejtori dhe Policia e Kosovës stacioni i Policisë në Istog të cilët kanë shoqëruar për në stacion Policor zyrtarin Korrektues është iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit.

Bazuar në provat e lëndës Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës pas obligimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar rastin e ankuesit, ndërsa Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar të gjitha faktet e prezantuar, dhe konstaton se në bazë të raportit informativ zyrtar të datës 18.12.2020 është pranuar informata zyrtare se ankuesi do të sjell kontrabandë për të burgosurit, si rrjedhojë është organizuar edhe bastisje e të gjithë stafit, ndërsa ankuesit më datë 19.12.2020, në pikën e kontrollit pranë Qendrës Korrektuese në Dubrëvë gjatë kontrllloës i është gjetur një telefon mobil i tipit UNIHERTZ, modeli JELLY PRO me nr.serik:352897092518203 (Made in China) pa sin kartelë dhe jo i mbushur me bateri kjo dëshmohej edhe me foto, duke mos e prezantuar se në kuletën e ti mban një telefon mobil.

Në bazë të dëshmitave të dëshmitarëve pranë Komisionit Disiplinor respektivisht në procesverbalin e datës 29.03.2021, dëshmitari deklaroi se "...of. e parë që ka ardh ka qenë H. është nënshkruar dhe i ka nxjerr të gjitha sendet e ka nxjerr kuletën ka kalu dhe mënjherë e ka kap kuletën e ka fut në xhep, unë i kam than se nuk bënë me fut në gjep pa e kontrolluar dhe e ka hap kuletën gjoja se nuk ka kurgjo...Të gjithë e kanë parë se në kult është gjetur një telefon...", po ashtu pranë Komisionit Disiplinor ka dëshmuar edhe i cili ka deklaruar se: "...vetëm kulta nuk është prcuaeduar në skaner nuk e di pse nuk është vendosur në skaner. E ka urdhëruar z. H.L që ta nxjee kuletën dhe e ka nxjerr telefoni ishte vendosur tek vendi i pareve të hekurit", ndërsa deklarata e dhënë nga ankuesi pranë Komisionit Disiplinor ka qenë kundërthënëse sepse i njëjti në një rast deklaroi se: "Djali ma ka dhënë me rregullu një tel, e tel ska pas bateri as sim kartë dhe kem pas me rregullu", ndërsa një rast tjetër deklaroi se "unë nuk kam qenë i sigurt se kam pas telefon me veti", ndërsa më tutje deklaroi se: "unë deklaroj se e pranon se mu ka gjet telefoni dhe e pranoj se ka qenë gabim dhe kam këkruar nga kolegët q të më falin gabimin... e pranoj se kam bërë gabim".

Bazuar në provat e lëndës, deklaratimet e dëshmitarëve dhe ankuesit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi ka tentuar të fus telefon brenda hapsirave të Qendrës Korrektuese në Dubravë në kundërshtim me parimet e ligjshmërisë dhe rregullat e brendshme të institucionit, sepse një gjë e tillë është rreptsisht e ndaluar me Rregullloren e Brendshme të Punës, me konkretisht me standardin e katërt pikë g ku thuhet: "**fut apo nxjerr nga burgu kontrabandë apo sene të palejuara**", kështu që ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të detyrave të punës të përcaktuar me nenin 46 paragrafin 3 nën paragrafin 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij, Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 01 /2016 Kodi i Etikës Profesionale për Zyrtarët Korrektues në Shërbimin Korrektues, sepse zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës siç parashihet me nenin 25 paragrafit 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike", po ashtu zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit siç parashihet me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa sipas nenit 28 të këtij ligji, zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij.

Në bazë të këtyre, meqenëse ankuesit ka bërë shkelje të rënda disiplinore, atëherë Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me rasiin e nxjerrës së Vendimin KD.NR.001/21 të datës 31.03.2021, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesja, në këtë rast ka vepruar në pajtim me nenin 45



të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësimit disiplinore si: *ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit*, mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, sepse është shqiptuar në raport të drejtë me shkeljen e kryer, rrjedhimisht udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses, ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*, nenin 13 paragrafin 4 nën paragrafët 4.1 dhe 4.2 dhe paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet e ankuesit se masa disiplinore e shqiptuar është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi janë të pabazuara.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të Vendimit me Nr. 0523 të datës 19.03.2021 është themeluar Komisioni Disiplinor në përbërje: Kryesues i Komisionit Disiplinor, anëtar i komisionit dhe Dashnim Osmani-anëtar i Komisionit, bazuar në këtë z. mban pozitën Menaxher i Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore që i njëjti të jetë edhe kryesues i komisionit disiplinor sepse i njëjti mban edhe pozitë të nivele të drejtues, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.314/2021

Avdyl BEKTESHI
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit Hajzer Loshi;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.